



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 2 Date 22.02.2017

“Për

“Dhënie mendim për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “ Zalli i Shtamës”, Përroi Zalli i Shtamës, degë e lumit Mat / Subjekti “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k”.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50 pika 2, 51 dhe nenit 52 ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe **nenit 24 pika c** të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, me propozim të A.B.U. Mat:

Këshilli i Basenit Ujor Mat,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**Zall Herr Energji 2011**”, me Administrator Z.Petrit Shahini, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike “ sipas studimit të paraqitur nga subjekti “**Zall Herr Energji 2011**”, me keto të dhëna:

Hec “Zalli i Shtamës”

- Prurja mesatare 1.59 m³/sek
- Prurja llogaritore 1.59m³/sek
- Kuota e aksit të vepres së marrjes: Z- 255m.n.d X -41 56 72.708 Y- 46 03 449.785
- Kuota e godines së HEC-it Z - 162 m.n.d X- 41 87 30.677 Y- 46 05 089.272
- Fuqia e instaluar deri 2MW
- Kapaciteti prodhues mesatar _____Kwh

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me uje të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast. NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA



240